



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit  
**611-26-1324-1-3-6/C923**



## K O N T R A T Ë / FURNIZIM

Emri i Projektit: **Furnizim me produkte tekstili dhe elemente te kuzhines per çerdhet publike te komunes se Drenasi**

Numri identifikues: : **611-26-1324-1-3-6** , 21.04.2026; Nr. i arkivit; 400-01/14266

### PALËT NË MARRËVESHJE

**KOMUNA E DRENASIT** , përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit ( më tutje “Punëdhënës”).

**"RIMI-ALTEX"SH.P.K., D.E KOMBIT, FERIZAJ** përfaqësuar nga Trim Goga, Drejtor (më tutje kontraktuese).

#### Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Furnizim me produkte tekstili dhe elemente te kuzhines per çerdhet publike te komunes se Drenasi**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **furnizimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup>.  
Periudha e kryes së punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** do të jetë deri në afatin : **10 dite**

3 Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **9,539.00 €**; [*Nentë mijë e Pesëqindë e Tridhjetë e Nentë euro* ]

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Kryetari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktoj në Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DKA-se.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Kryetari i Komunes.

## **Neni 7 Garancioni i shërbimeve]**

7.1 Garancioni aplikohet sipas pershkrimeve ne paramas .

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [ të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e

res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

## Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjehere pas nenshkrimit.**

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	Trim Goga
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënskrimi:		Nënskrimi:	
Data:	21-04-2026	Data:	21-04-2026
Vula:		Vula:	

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Furnizim me produkte tekstili dhe elemente të kuzhinës për çerdhet publike të Komunës së Drenasit

Nr.	Emri i produktit	Specifikacioni teknik të produktit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH
1	JOSTAK për fëmijë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmasa: 30 x 50 x 10 cm.</li> <li>• Toleranca e lejuar: ±3 cm.</li> <li>• Mbushja: 100% fibër sintetike antialergjike (poliester silikonizuar).</li> <li>• Peshë minimale: 300 gram.</li> <li>• Fortësia: E butë – jastëku duhet të rikthehet në formë brenda 5 sekondave pas shtypjes me dorë (verifikim fizik nga komisioni i pranimit).</li> <li>• Shtresa e jashtme: 100% pambuk.</li> <li>• Ngjyra: E bardhë (pa printime).</li> <li>• Larja: E qëndrueshme ndaj larjes industriale, pa deformim dhe pa grumbullim të mbushjes.</li> </ul>	cope	300	3	900.00
2	SET ÇARÇAFASH (3 pjesë)	<p>Seti duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 çarçaf për dyshek (120 x 60 cm, me llastik rrethor)</li> <li>• 1 këllëf jorgani (120 x 90 cm)</li> <li>• 1 këllëf jostaku (30 x 50 cm)</li> </ul> <p>Specifikime të detyrueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiali: 100% pambuk.</li> <li>• Dendësia e pëlhurës: Minimum 140 gr/m<sup>2</sup>.</li> <li>• Ngjyra: E bardhë (pa printime).</li> <li>• Larja: E qëndrueshme në 90°C, me tkurrje jo më shumë se 5%.</li> <li>• Mbyllja e këllëfëve: Zinxhir plastik i fshehur ose kapak tekstil. Nuk lejohen kopsa metalike.</li> </ul>	cope	300	10	3,000.00
3	JORGAN PËR FËMIJË	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmasa: 120 x 90 cm.</li> <li>• Toleranca e lejuar: ±3 cm.</li> <li>• Mbushja: 100% fibër sintetike antialergjike (poliester silikonizuar).</li> <li>• Peshë e mbushjes: 250–300 gr/m<sup>2</sup>.</li> <li>• Peshë totale: Minimum 500 gram.</li> <li>• Shtresa e jashtme: 100% pambuk.</li> <li>• Qepja: E ndarë në kuadrate ose kanale (e dukshme vizualisht) për të parandaluar grumbullimin e mbushjes.</li> <li>• Ngjyra: E bardhë (pa printime).</li> <li>• Larja: E qëndrueshme në 90°C pa deformim dhe pa grumbullim të mbushjes.</li> </ul>	cope	300	6	1,800.00
4	Lugë për fëmijë	<p>Materiali: Çelik inox 18/10 ose 18/0</p> <p>Gjatësia: 14–16 cm</p> <p>Trashësia min.: 1.5 mm</p> <p>Skaje të rumbullakosura</p>	cope	300	1	300.00

5	Pirun për fëmijë	Materiali: Çelik inox 18/10 ose 18/0 Gjatësia: 14–16 cm Dhëmbë të rumbullakosur (jo të mprehtë) Trashësia min.: 1.5 mm	cope	300	1	300.00
6	Pjatë e sheshtë për fëmijë	Materiali: Polipropilen food grade ose melaminë e fortë Diametri: 20–22 cm Rezistente ndaj rënies	cope	300	2	600.00
7	Pjatë e thellë për fëmijë	Materiali: Polipropilen food grade ose melaminë Diametri: 18–20 cm Thellësia min.: 3 cm	cope	300	2	600.00
8	Tas (për supë/drithëra)	Materiali: Polipropilen food grade Kapaciteti: 300–400 ml	cope	300	1	300.00
9	Gotë për fëmijë	Materiali: Polipropilen food grade Kapaciteti: 200–250 ml Rezistente ndaj thyerjes	cope	300	1	300.00
10	Tabllo (tabaka)	Materiali: Polipropilen i fortë ose inox Përmasa: rreth 40 x 30 cm Me buzë ngritëse min. 2 cm	cope	250	1	250.00
11	Bokall elektrik për vlim uji	Kapaciteti: 5 litra Material: Inoks ose plastikë rezistente ndaj temperaturës Fuqia minimale: 1500W Me sistem automatik fikjeje dhe mbrojtje nga mbinxehja	cope	6	15	90.00
12	Bokall dore për shërbim uji	Kapaciteti: min. 2 L Material: Plastikë ushqimore (BPA free) Të përshtatshme për përdorim nga fëmijët Të lehta dhe rezistente ndaj thyerjes	cope	10	3	30.00
13	Thikë kuzhine për personel	Materiali: Çelik inox Gjatësia e tehut: min 20 cm Dorzë ergonomike, jo rrëshqitëse	cope	20	3	60.00
14	Dërrasë prerjeje	Materiali: Polietilen food grade Përmasa min.: 40 x 30 cm Trashësia min.: 1.5 cm	cope	10	3	30.00
15	ENË PËR ZIERJE (PËR GATIM/ AVULLIM)	Materiali: Inox (18/10). Kapaciteti: 10-15 litra. Diametri i fundi: min. 20 cm. Kapak inox i përshtatshëm (me dorzë). Dorzë: inox, e ngrohtë (jo plastike). E përshtatshme për larje në enëlarëse industriale.	cope	4	4	16.00
16	TENXHERE PËR RUATJE USHQIMI (TERMOKUPË)	Materiali: Inox 18/10 (brendshme dhe jashtme). Kapaciteti: 10–15 litra. Izolim termik: dy shtresa (vakum ose poliuretan). Kapak i mbyllur me ngjitje të fortë (jo thjesht "këmbë" mbi). Dorzë të fortë dhe të qëndrueshme për bartje. Të jetë e përshtatshme për larje në enëlarëse (nëse prodhuesi e lejon).	cope	4	5	20.00

17	<b>TENXHERE PËR ZIRJE USHQIMI</b>	Material: Inoks profesional (18/10 ose ekuivalent) Kapaciteti: 80 L Me kapak Fund i përforcuar (i përshtatshëm për gatim industrial) Rezistente ndaj temperaturave të larta	cope	2	5	10.00
18	<b>TENXHERE PËR ZIRJE USHQIMI</b>	Material: Inoks profesional (18/10 ose ekuivalent) Kapaciteti: 60 L Me kapak Fund i përforcuar (i përshtatshëm për gatim industrial) Rezistente ndaj temperaturave të larta	cope	4	5	20.00
19	<b>Tiganë Ø 48 cm, 50 cm dhe 55 cm</b>	Material: Inoks (çelik inox) cilësor për përdorim profesional Trashësia minimale: 3–5 mm Dorezë rezistente ndaj nxehtësisë Të përshtatshme për përdorim intensiv (kuzhinë kolektive) Të lehta për pastrim dhe rezistente ndaj korrozionit	set	2	4	8.00
20	<b>LUGE PËR PËRZIERJE (PËR GATIM)</b>	Materiali: Druri i fortë ose silikon food grade. Gjatësia: 30–35 cm. Sipërfaqe pa skaje të mprehta. Të jetë e qëndrueshme ndaj temperaturave të larta (nëse silikon, min. 220°C). Të jetë e lehtë për pastrim. Etiketë me materialin dhe udhëzime pastrimi.	cope	10	2	20.00
21	<b>Kutllaça (lugë për shërbim)</b>	Material: Inoks Gjatësi min. 30 cm Rezistente ndaj temperaturave të larta	cope	6	3	18.00
22	<b>TABAK PËR SERVIM (ME NDARJE TË GJLLEVE, SALATËS, LUGE, BUKES ETJ.)</b>	Materiali: Polipropilen food grade ose inox. Përmasa: 30 x 20 cm (±2 cm). Të ketë ndarje të dukshme (min. 2 ndarje). Të jetë e lehtë për pastrim dhe dezinfektim. Të jetë e qëndrueshme ndaj rënies. Etiketë me materialin (food grade).	cope	200	2	400.00
23	<b>Shporta druri për bukë</b>	Material: Dru natyral i përpunuar Sipërfaqe e lëmuar dhe e sigurt për përdorim ushqimor Madhësi mesatare për shërbim tavoline	cope	40	2	80.00

24	<b>Shporta për bartjen e bukës</b>	Materiali: Plastikë ushqimore (BPA Free), e fortë dhe rezistente Kapaciteti: min. 30–40 L Dizajni: Me doreza anësore për bartje të sigurt Struktura: Anë të ventiluar (me vrima) për ajrosje të bukës Higjiena: E përshtatshme për kontakt me ushqim, e lehtë për pastrim dhe dezinfektim Qëndrueshmëria: Rezistente ndaj goditjeve dhe deformimit gjatë transportit Opsionale: Me kapak mbrojtës për transport higjienik	cope	10	2	20.00
25	<b>Enë plastike për bartjen e sallatës</b>	Kapaciteti: 8 litra Material: Plastikë ushqimore (BPA free) Me kapak Rezistente dhe e lehtë për transport	cope	8	1	8.00
26	<b>Kullojsa plastike</b>	Material: Plastikë ushqimore cilësore Madhësi e mesme deri e madhe Rezistente ndaj temperaturave dhe goditjeve	cope	4	1	4.00
27	<b>MBULESE PËR TAVOLINA (MBULUESE PLOTËSISHT TË PASHTROHSHME)</b>	Materiali: PVC i fortë ose poliester i veshur (food grade). Përmasa: të përshtatshme për tavolinat e çerdhes. Trashësia min. 200 gr/m <sup>2</sup> (për poliester). Të jetë jo rrëshqitëse dhe e lehtë për pastrim. Të jetë e papërshkueshme nga uji. Larja/ pastrimi: me detergjent normal dhe dezinfektues.	cope	20	2	40.00
28	<b>UNIFORME PËR PERSONEL (ME KAPEL)</b>	Materiali: 65% pambuk + 35% poliester (ose 100% pambuk). Ngjyra: e bardhë (ose ngjyrë e hapur). Përmasat: të gjitha madhësitë standarde (S, M, L, XL). Kapelë: 100% pambuk ose poliester, me kapje të rregullueshme. Uniforma duhet të ketë qepje të forta dhe të jetë e qëndrueshme ndaj larjes në 90°C. Etiketë me përbërjen dhe udhëzime larjeje.	cope	10	15	150.00
29	<b>PESHQIRË KUZHINE</b>	Materiali: 100% pambuk (min. 180 gr/m <sup>2</sup> ). Përmasa: min 50 x 140 cm Ngjyra: e bardhë ose pastel e lehtë (pa printime). Larja: e qëndrueshme në 90°C pa deformim. Çdo peshqir duhet të ketë etiketë me përbërjen dhe përmasat.	cope	50	3	150.00
30	<b>PESHORE</b>	Pesha: min 150Kg Saktësia e matjes: ±2g Struktura: Metalike me platformë	cope	1	15	15.00
<b>TOTALI ME TVESH:</b>						<b>9,539.00</b>

Afati i lifrimit: 10 dite (Afati është i shkurtuar përshkak të hapjes së qerdheve të reja)

**Vërejtje: Të gjitha produktet duhet të kenë etiketë me përbërje, përmasa dhe të dhëna nga prodhuesi; çdo devijim nga specifikimet e kërkuara çon në refuzim të mallit.**